



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:254083

Datë: 14.03.2024

Numri i dokumentit: 05452553

C-IV.-14-6011

B G nga f.sh A K.Prizren.

Ankuesi:

Kundër:

E paditura:

N.SH “Unimont”, e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Hajrie Shala, me dt.05 mars 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- Procedura në këtë çështje juridike NDËRPRITET për shkak të vdekjes së ankuesit B G .**
- Procedura do të vazhdohet kur trashëgimtarët e të ndjerit kërkojnë vazhdimin e procedurës.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me dt.29 gusht 2014, ankuesi ish punëtor i NSH “Unimont” ka ushtruar ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovë (më tej “Dhoma e Posaçme”) kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit (më tutje AL) nr.PRZ018-0038 i dt.20 gusht 2014, me të cilin ka kërkuar kompensimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 1,920.€. Ankuesi në ankesë ka deklaruar se AL ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës

administrative, një vendim i tillë është kundërthënës, jo objektiv dhe i pakuptueshëm dhe si i tillë nuk mund të qëndroj pasi që nuk është lesuar fare në të dhënat dhe provat relevante të paraqitura në ankesë. Ankesës i ka bashkangjitur këto prova: Kopjen e vendimit të atakuar, Kontratën e punës, Njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj lënde, me dt.06 tetor 2023 ka lëshuar një urdhër për ankuesin përmes të cilit ka kërkuar nga ankuesi që të bëjë dorëzimin e kopjes së vendimit të atakuar, njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës, kopjen e librezës së punës, dhe kopjen e listës së pagave. Në këtë rast bashkëshortja e ankuesit i është përgjigjur urdhërit me dt.09 nëntor 2023, duke e bërë dorëzimin e këtyre provave: Njoftimi i NSH nr.6200/13 dt.05.09.2013, Certifikata e vdekjes së ankuesit B G t , Vendimi nr.8/94 dt.02.08.1994, Kontrata e punës, si dhe kopjen e letërnjoftimit të ankuesit dhe kopjen e letërnjoftimit të Sh G, Vërtetim i NSH dt.10.02.2003.

Me dt.01 dhjetor 2023 e paditura AKP-ja ka parashtruar mbrojtje në ankesë.

Arsyetimi ligjor

Procedura në këtë çështje juridike ndërpritet për shkak të vdekjes së ankuesit.

Sipas nenit 76 par.3 të Ligjit Nr.06-L-086 Për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës parasheh: “Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë *mutatis mutandis* dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.”

Kurse sipas dispozitës së nenit 277 pika (a) të LPK-së: Procesi gjyqësor ndërpritet: a) kur pala ndërgjyqëse vdes ose e humbë zotësinë procedurale.

Në vazhdim dispozita e nenit 280 par. 1 të LPK-së parasheh: “Procedura që është ndërprerë për shkaqe të treguara në nenin 277 paragrafi 1 pika a)–d) të këtij ligji do të vazhdohet kur trashëgimtari, apo kujdestari i pasurisë trashëgimore, përfaqësuesi i ri ligjor, administratori i falimentimit apo pasardhësi juridik i personit juridik, e marrin përsipër procedurën apo kur i thërret gjykata ta bëjnë këtë.”

Andaj, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, konform nenit 277 pika (a), nenit 280 par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe bazuar në Ligjin nnr.04/L-118 për ndyshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore. .

Këshillë juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gj y q t a r j a
Hajrie Shala